

14  
20/09/2012



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E FINANCAVE  
KABINETI

100 Vjet Pavarësi

Nr. 14385/ Prot.

Tiranë, më 17-9 2012

URDHER

Nr. 54, Datë 17/9/2012

Për

**shpalljen e disa standardeve ndërkombëtare të reja të raportimit financiar si dhe të disa ndryshimeve të ndodhura gjatë vitit 2011 në standardet ndërkombëtare të kontabilitetit (SNK) dhe në standardet ndërkombëtare të raportimit Financiar (SNRF)**

Në mbështetje të nenit nr. 4, pika 3, të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, i ndryshuar, të VKM nr. 672, datë 26.10.2005 "Për miratimin e rregullores së brendëshme të organizimit dhe të funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit dhe sipas Vendimit nr. 2, datë 12.9.2012 të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit,

URDHEROJ

- Shpalljen për zbatim të standardeve ndërkombëtare të reja të raportimit financiar si dhe të disa ndryshimeve të ndodhura gjatë vitit 2011 në standardet ndërkombëtare të kontabilitetit (SNK) dhe në standardet ndërkombëtare të raportimit Financiar (SNRF), të hartuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit gjatë vitit 2011, dhe të përkthyer në shqip nga gjuha angleze nën përgjegjësinë e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, si më poshtë:
  - Standarde të reja të Raportimit Financiar (SNRF) nr. 10, nr. 11, nr. 12 dhe nr. 13
  - Kostot e Largimit në Fazën e Prodhimit të një Miniere Sipërfaqësore (KIRFN) nr. 20.
  - Ndryshime në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) nr. 1, nr. 19 dhe nr. 32
  - Ndryshime në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) nr.7 dhe nr. 9Tekstet e të cilëve janë bashkëlidhur këtij Urdhëri dhe janë pjesë integrale e tij.
- Njësitë ekonomike, të cilat sipas parashikimeve të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për Kontabilitetin dhe Raportimin Financiar" janë të detyruara të zbatojnë standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit financiar, të aplikojnë standardet e reja dhe ndryshimet si në pikën 1 të këtij Urdhëri, duke filluar nga data 1 janar 2013.
- Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen e internetit të Ministrisë së Financave dhe në atë të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit.

Ridvan BODE

MINISTER

